AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMEVE

MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMEVE

DREJTORIA E ZVILLIMIT TË PROGRAMEVE DHE OFRUESVE

Standardi i Profesionit

"Mësimdhënës i Kulturës Profesionale në AFP"

Kodi 2320 (në LKP[1])

Tiranë, 2025

[1] Lista Kombëtare e Profesioneve

Profesioni "Mësimdhënës i Kulturës Profesionale në AFP"

Kodi: 2320 "Mësues të shkollave profesionale dhe teknike"

Vlefshmëria e standardit: 4 vjet

Kërkesat për hyrje:

Disa kërkesa për hyrje në këtë profesion:

- Të kenë një diplomë universitare në fusha përkatëse.
- Për pozicione të caktuara si mësimdhënës/instruktor praktike në shkolla profesionale, instruktorë të formimit profesional duhet të kenë kualifikim profesional të nivelit të arsimit të mesëm profesional (ose pas të mesëm) dhe përvojë pune në fushën përkatëse profesionale.
- Të jetë në kushte shëndetësore që lejojnë kryerjen e detyrës.

Data e miratimit:

Variantet e mëparshme: **Viti 2021**

Përshkrim i përgjithshëm i profesionit

Mësuesit e shkollave profesionale dhe teknike japin mësim, shpjegojnë ose udhëzojnë lëndët**,** modulet dhe praktikat profesionale në institucionet e arsimit profesional, në shkollat e mesme, në kolegje dhe qendra të formimit apo trajnimit profesional për të rritur. Ata përgatisin nxënësit/kursantët për punësim në profesione të caktuara apo fusha profesionale për të cilat nuk kërkohet arsimi i lartë universitar. Ata mund të punësohen në shkolla profesionale publike apo private, kolegje profesionale, qendra formimi dhe trajnimi profesional, biznese apo institucione të tjera që aplikojnë shërbime të arsimit dhe formimit profesional apo të vetë-punësohen.

Standardi i Profesionit "Mësimdhënës të Kulturës Profesionale në AFP"

Mësimdhënës të kulturës profesionale në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) janë persona që drejtojnë procesin mësimor në kuadër të këtij sektori të zhvillimit të burimeve njerëzore në Shqipëri. Standardi i profesionit konsideron këto kategori mësimdhënësish të angazhuar në AFP (përfshirë dhe atë të formës së dyfishtë):

a) Mësimdhënësit e teorisë dhe/ose praktikës profesionale, me arsim të lartë.

b) Mësimdhënësit e praktikës profesionale, me arsim të mesëm dhe pas të mesëm profesional.

c) Mentorët e biznesit të angazhuar në AFP të dyfishtë.

Ky standard përcakton kompetencat e mësimdhënësit të kulturës profesionale të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) që nevojiten për të drejtuar një proces mësimor me cilësi të lartë me në qendër nxënësin/kursantin. Standardi profesional përmban kompetencat sociale, kompetencat pedagogjike dhe kompetencat profesionale të fushës ku mësimdhënësi jep mësim.

Standardi i profesionit "Mësimdhënës të kulturës profesionale në AFP" udhëheq dhe lehtëson punën e mësimdhënësit të kulturës profesionale në arsimimin dhe formimin e të rinjve dhe të rriturve nëpërmjet njohjes dhe përdorimit të parimeve bazë të didaktikës dhe të metodave moderne të mësimdhënies në arsim dhe formim profesional bazuar në kompetenca.

Mësimdhënësi i kulturës profesionale në AFP njeh dhe zbaton në punë parimet bazë: të planifikimit të të nxënit për grupet e synuara; të organizimit dhe realizimit të seancave të mësimdhënies dhe trajnimit (me prezencë fizike, online ose të kombinuar) në përputhje me situatat, objektivat mësimore dhe rezultatet e të nxënit; të përgatitjes dhe përdorimit të medieve të mësimdhënies; të përzgjedhjes dhe përgatitjes së instrumentave të vlerësimit; të vlerësimit të të nxënit në përputhje me objektivat; të hartimit të programeve mësimore në nivel ofruesi, etj. Standardi profesional u zhvillua bazuar në kërkime dhe analiza në shkallë të gjerë, në bashkëpunim të ngushtë me palët e interesuara.

(A) Mësimdhënësit e teorisë dhe/ose praktikës profesionale, me arsim të lartë dhe (B) Mësimdhënësit e praktikës profesionale, me arsim të mesëm profesional, trajtojnë lëndë profesionale dhe/ose module profesionale në shkollat profesionale që ofrojnë kualifikime profesionale të nivelit të mesëm dhe pas të mesëm (nivelet 2 ÷ 5 të KSHK), si dhe në qendra të formimit profesional që ofrojnë kurse të shkurtëra të formimit profesional. Ata përgatisin nxënësit dhe kursantët për punësim në profesione ose fusha profesionale të caktuara, për të cilat zakonisht nuk kërkohet arsimi i lartë universitar.

Standardi i profesionit për këto kategori mësimdhënësish, përbëhet nga funksionet e mëposhtme:

Funksioni	Përshkrimi i funksionit
1. Analiza dhe planifikimi i veprimtarisë mësimore.	Planifikimi i procesit mësimor duke marrë parasysh nevojat e nxënëseve/kursantëve dhe bazuar në analizën e programit mësimor, teknologjive moderne dhe praktikës së punës, duke zbatuar kërkesat përkatëse ligjore, rregullatore dhe institucionale në procesin e planifikimit.
2. Organizimi i mjedisit mësimor	Krijimi i një mjedisi mësimor të sigurt, mbështetës dhe gjithëpërfshirës, real dhe virtual, për të motivuar dhe mbështetur nxënësit dhe kursantët, në arritjen e rezultateve të të nxënit në mënyrë efektive, duke respektuar veçoritë individuale të tyre.
3. Realizimi i seancave mësimore	Drejtimi i procesit të të nxënit me në qendër nxënësin/kursantin dhe cilësor duke përdorur metoda, teknologji dhe burime mësimore moderne, përfshirë dhe ato digjitale, në përputhje me parimet didaktike, kërkesat e programit mësimor dhe veçoritë individuale të

	nxënësve dhe kursantëve.
4. Vlerësimi i arritjeve të nxënësve dhe kursantëve.	Përgatitja dhe përdorimi i instrumenteve të vlerësimit, përfshirë dhe ato digjitale, që lidhen me parimet e vlerësimit dhe rezultatet e të nxënit të përcaktuara në programin mësimor, si dhe realizimi i procesit të vlerësimit të sipas kritereve të përcaktuara dhe veçorive individuale të nxënësve dhe kursantëve.
5. Zhvillimi i aftësive "të buta" të nxënësve dhe kursantëve	Krijimi i mjedisit mësimor dhe zbatimi i metodave mësimore që mundësojnë përfshirjen aktive të nxënësve dhe kursantëve në veprimtari të të nxënit që zhvillojnë aftësitë "e buta" (të shekullit 21) dhe i integrojnë këto aftësi te kompetencat profesionale përkatëse.
6. Krijimi i marrëdhënieve profesionale në punë.	Zhvillimi i marrëdhënieve bashkëpunuese, etike dhe efektive me nxënësit/kursantët, eprorët, kolegët, prindërit, përfaqësuesit e biznesit dhe aktorët e tjerë të AFP-së.
7. Zhvillimi i vazhduar profesional i mësimdhënësve të kulturës profesionale të AFP-së.	Pjesëmarrja aktive në veprimtari për zhvillimin e vazhdueshëm profesional, përfshirë dhe studimin individual online, bazuar në kërkesat e profesionit, zhvillimet didaktike dhe analizën e nevojave personale.
8. Zbatimi i rregullave të sigurisë, mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm	Zbatimi me korrektësi i parimeve dhe i rregullave të sigurisë, higjienës, shëndetit, mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm në mjediset e realizimit të procesit mësimor.

“MËSIMDHËNËS TË KULTURËS PROFESIONALE NË AFP”					
Funksionet	**Detyrat**	**Njohuritë**	**Shprehitë**	**Qëndrimet**	**Kriteret e përmbushjes**
1. Analiza dhe planifikmi i veprimtarisë mësimore.	1. Zbaton kërkesat ligjore, rregullatore dhe institucionale për procesin mësimor në AFP. 2. Zbaton rregulloren e brendshme të institucionit ofrues të AFP-së. 3. Identifikon qasje të reja për mësimdhënien, të nxënit dhe vlerësimin e nxënësve dhe kursantëve. 4. Analizon kërkesat e standardeve të kualifikimeve profesionale dhe të kurrikulave të AFP-së. 5. Identifikon nevojat dhe potencialin e nxënësve dhe kursantëve. 6. Propozon ndryshime në kurrikulat kombëtare për t’i përshtatur me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimet teknologjike. 7. Zhvillon kurrikulat në nivel ofruesi (plane mësimdhënieje për lëndët teorike, për modulet praktike dhe për praktikat në biznes) 8. Planifikon procesin e mësimdhënies dhe të të nxënit për seancat mësimore teorike dhe praktike. 9. Përzgjedh metodat të përshtatshme, aktive, të mësimdhënies dhe të të nxënit. 10. Përzgjedh metodat dhe instrumentet e përshtatëshme	• Kuadri ligjor, rregullator dhe institucional për procesin mësimor në AFP. • Përmbajtja e rregullores së brendshme të ofruesit të AFP-së • Qasjet e reja për mësimdhënien, të nxënit dhe vlerësimin e nxënësve dhe kursantëve. • Kërkesat e standardeve të kualifikimeve profesionale dhe të kurrikulave të AFP-së. • Metodologjia për analizën e nevojave dhe të potencialit të nxënësve dhe kursantëve. • Struktura e skeletkurrikulave të arsimit profesional dhe e programeve të kurseve të unifikuara të formimit profesional • Metodologjia dhe kriteret e përshtatjes së kurrikulave të AFP-së me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimet teknologjike. • Struktura e kurrikulave në nivel ofruesi (planet e mësimdhënies për lëndët teorike, për modulet praktike dhe për praktikat në biznes) • Metodologjia e planifikimit të seancave mësimore teorike dhe praktike. • Veçoritë e metodave aktive të mësimdhënies dhe të të nxënit. • Veçoritë e metodave dhe	– Zbaton kuadrin ligjor dhe rregullator për procesin mësimor në AFP – Zbaton rregulloren e brendshme të institucionit ofrues të AFP-së. – Integron qasjet e reja për mësimdhënien dhe të nxënit në planifikimin e procesit mësimor – Përmbush kërkesat e standardeve të kualifikimeve dhe të kurrikulave të AFP-së – Integron mësimdhënien me nxënësit dhe kursantët në qendër, në planifikimin e procesit mësimor. – Propozon ndryshime në kurrikulat kombëtare për t’i përshtatur me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimet teknologjike. – Përgatit planet e mësimdhënies për lëndët teorike, modulet praktike dhe praktikat në biznes. – Përgatit ditaret për seancat mësimore teorike dhe praktike. – Përzgjedh metoda aktive të mësimdhënies dhe të të nxënit. – Përzgjedhë metoda dhe instrumente të përshtatshme për	– Të jetë korrekt/e – Të jetë bashkëpunues/e – Të jetë i/e kujdesshëm – Të jetë i/e përpiktë – Të komunikojë me etikë profesionale. – Të ketë paraqitje korrekte – Të jetë këmbëngulës – Të jetë i/e vendosur. – Të jetë i/e duruar. – Të jetë krijues. – Të jetë empatik/e.	– Të përshkruajë kuadrin ligjor, rregullator dhe institucional të AFP-së – Të zbatojë rregulloren e brendshme të ofruesit të AFP-së – Të përshkruajë veçoritë e qasjeve të reja për mësimdhënien, të nxënit dhe vlerësimin e nxënësve dhe kursantëve. – Të analizojë dhe përmbushë kërkesat e standardeve të kualifikimeve profesionale dhe të kurrikulave të AFP-së. – Të përshkruajë metodologjinë për analizën e nevojave dhe të potencialit të nxënësve dhe kursantëve. – Të përshkruajë procedurën dhe kriteret e përshtatjes së kurrikulave të AFP-së me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimet teknologjike. – Të hartojë planet e mësimdhënies për lëndët teorike profesionale, modulet praktike dhe `praktikat në biznes – Të përgatitë planet (ditatet) e seancave mësimore teorike dhe praktike. – Të përzgjedhë metoda aktive të mësimdhënies dhe të të nxënit. – Të përzgjedhë metodat dhe instrumentet e përshtatshme për vlerësimin e nxënësve e kursantëve. – Të përcaktojë burimet mësimore dhe mediet didaktike (përfshirë ato digjitale) për zhvillimin efektiv të

	për vlerësimin e arritjeve të nxënësve dhe kursantëve. 11. Planifikon burimet e duhura mësimore, si dhe mediet didaktike (përfshirë ato digjitale) për zhvillimin efektiv të procesit mësimor. 12. Bashkëpunon me mësimdhënësit e tjerë dhe koordinatorët e NJZH-së për planifikimin e procesit mësimor. 13. Plotëson dokumentet për procesin mësimor dhe për nxënësit e kursantët	instrumenteve për vlerësimin e arritjeve të nxënësve dhe kursantëve. • Veçoritë e burimeve mësimore dhe medieve didaktike (përfshirë ato digjitale) për zhvillimin efektiv të procesit mësimor. • Rëndësia e bashkëpunimit me mësimdhënësit e tjerë dhe koordinatorët e NJZH-së për planifikimin e procesit mësimor. • Struktura dhe kërkesat e dokumentacionit për procesin mësimor dhe për nxënësit e kursantët.	vlerësimin e nxënësve dhe kursantëve. – Planifikon nevojat për organizimin e mjedisit mësimor. – Plotëson dokumentet për procesin mësimor dhe për nxënësit e kursantët		procesit mësimor. – Të argumentojë rëndësinë e bashkëpunimit me mësimdhënësit e tjerë dhe koordinatorët e NJZH-së për planifikimin e procesit mësimor – Të plotësojë dokumentacionin që lidhet me procesin mësimor dhe me nxënësit e kursantët
2. Organizimi i mjedisit mësimor	1. Përshtat mjedisin mësimor në përputhje me planin e seancës mësimore përkatëse, teorike dhe praktike. 2. Përshtat mjedisin mësimor që të mbështesë pjesëmarrjen aktive të të gjithë nxënësve dhe kursantëve në procesin mësimor. 3. Përshtat mjedisin mësimor sipas veçorive individuale të nxënësve dhe kursantëve, përfshirë dhe të atyre me nevoja të veçanta. 4. Përshtat mjedisin mësimor që të mundësojë gjithpërfshirjen e nxënësve dhe kursantëve në procesin mësimor. 5. Përshtat mjedisin mësimor që të jetë stimulues dhe motivues për nxënësit dhe kursantët. 6. Siguron mediet e nevojshme didaktike për realizimin efektiv të procesit mësimor. 7. Siguron mjetet, pajisjet dhe materialet e nevojshme për	• Veçoritë e mjedisit mësimor që mbështet pjesëmarrjen aktive të të gjithë nxënësve e kursantëve në procesin mësimor. • Kërkesat për mjedise mësimore që konsiderojnë veçoritë individuale të nxënësve dhe kursantëve, përfshirë dhe të atyre me nevoja të veçanta. • Kërkesat për mjedise mësimore që mundësojnë gjithpërfshirjen e nxënësve dhe kursantëve në procesin mësimor. • Kërkesat për mjedise mësimore që stimulojnë dhe motivojnë nxënësit dhe kursantët. • Llojet dhe përdorimet e medieve didaktike për realizimin efektiv të procesit mësimor. • Llojet dhe përdorimet e mjeteve, pajisjeve dhe materialeve për realizimin e veprimtarive mësimore teorike dhe praktike • Kërkesat për mjedise mësimore	– Organizon mjedisin mësimor në përputhje me veprimtaritë e seancës mësimore, teorike dhe praktike. – Përshtat mjedis mësimor që mundëson pjesëmarrje aktive dhe githpërfshirje të nxënësve e kursantëve. – Përshtat mjedis mësimor sipas veçorive individuale të nxënësve dhe kursantëve, përfshirë dhe të atyre me nevoja të veçanta. – Përshtat mjedis mësimor që mundëson stimulimin dhe motivimin e nxënësve dhe kursantëve. – Përzgjedh dhe siguron mediet didaktike për realizimin efektiv të procesit mësimor. – Përzgjedh dhe siguron mjetet, pajisjet dhe materialet për realizimin efektiv të procesit	– Të jetë korrekt/e – Të jetë bashkëpunues/e – Të jetë i/e kujdesshëm – Të jetë i/e përpiktë – Të komunikojë me etikë profesionale. – Të ketë paraqitje korrekte – Të jetë këmbëngulës – Të jetë i/e vendosur. – Të jetë i/e duruar. – Të jetë krijues. – Të jetë empatik/e.	– Të përshtatë mjedisin mësimor në funksion të planit të realizimit të seancës mësimore, teorike dhe praktike. – Të përshtatë mjedisin mësimor në funksion të pjesëmarrjen aktive dhe gjithëpërfshirjes së nxënësve dhe kursantëve në procesin mësimor – Të përshtatë mjedisin mësimor në funksion të veçorive individuale të nxënësve dhe kursantëve, përfshirë dhe të atyre me nevoja të veçanta. – Të përshtatë mjedisin mësimor që të mundësohet stimulimi dhe motivimi i nxënësive e kursantëve – Të sigurojë mediet e duhura didaktike për realizimin efektiv të procesit mësimor. – Të sigurojë mjetet, pajisjet dhe materialet e duhura për realizimin e veprimtarive mësimore teorike dhe praktike – Të përshtatë mjedisin mësimor që të garantojë barazi gjinore, mundësi të barabarta dhe pranim të diversitetit për nxënësit e kursantët

	realizimin e veprimtarive mësimore teorike dhe praktike 8. Përshtat mjedisin mësimor që të garantojë barazinë gjinore, mundësi të barabarta dhe pranimin e diversitetin për nxënësit dhe kursantët 9. Përshtat në mënyrë të vazhdueshme mjedisin mësimor për të përmirësuar efektivitetin e procesit mësimor. 10. Zbaton rregulloret, standardet dhe kërkesat në lidhje me organizimin e mjedisit mësimor teorik dhe praktik në ofruesit e AFP-së. 11. Zbaton kërkesat e sigurisë dhe të zhvillimit të qëndrueshëm në mjedisin mësimor	që garantojë barazinë gjinore, mundësi të barabarta dhe pranimin e diversitetin për nxënësit dhe kursantët • Nevoja për përshtatjen e vazhdueshme të mjedisit mësimor për të përmirësuar efektivitetin e procesit mësimor. • Kërkesat e rregulloreve dhe standardeve në lidhje me organizimin e mjedisit mësimor teorik dhe praktik në ofruesit e AFP-së. • Kërkesat për sigurinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm në organizimin e mjediseve mësimore teorike dhe praktike	mësimor – Përshtat mjedisi mësimor që mundëson barazinë gjinore, mundësi të barabarta dhe pranimin e diversitetin për nxënësit dhe kursantët – Zbaton rregulloret, standardet dhe kërkesat që lidhen me organizimin e mjedisit mësimor – Zbaton kërkesat e sigurisë dhe të zhvillimit të qëndrueshëm në mjedisin mësimor		– Të përshtatë vazhdimisht mjedisin mësimor në funksion të përmirësimit të efektivitetit të procesit mësimor. – Të zbatojë rregulloret, standardet dhe kërkesat në lidhje me organizimin e mjedisit mësimor teorik dhe praktik – Të zbatojë kërkesat e sigurisë dhe të zhvillimit të qëndrueshëm në mjedisin mësimor teorik dhe praktik
3. Realizimi i seancave mësimore	1. Kryen veprimtari mësimore, bazuar te plani i seancave mësimore, teorike dhe/ose praktike. 2. Kryen veprimtari mësimore në përputhje me objektivat mësimorë/ rezultatet e të nxënit. 3. Përdor materiale mësimore didaktike të përshtatshme dhe të përditësuara. 4. Harton materiale mësimore didaktike të reja kur është e nevojshme. 5. Përdor teknologji dhe media didaktike moderne për realizimin e seancave mësimore. 6. Zbaton qasje mësimore që mundësojnë pjesmarrje aktive	• Struktura e planit të mësimdhënies teorike dhe/ose praktike • Llojet dhe përdorimet e materialeve mësimore didaktike • Llojet dhe përdorimet e mediave didaktike moderne. • Veçoritë e qasjeve mësimore që mundësojnë gjithëpërfshirje të nxënësve dhe kursantëve. • Veçoritë e qasjeve mësimore që mundësojnë barazinë sociale dhe gjinore të nxënësve dhe kursantëve. • Veçoritë e qasjeve mësimore që mundësojnë mësimin e individualizuar të nxënësve dhe kursantëve. • Veçoritë e qasjeve mësimore që mundësojnë pjesëmarrjen aktive	– Realizon seanca dhe veprimtari mësimore, teorike dhe/ose praktike. – Përgatit dhe përdor materiale mësimore didaktike në mbështetje të procesit mësimor. – Përdor teknologji dhe media didaktike moderne gjatë seancave mësimore. – Zbaton llojshmëri qasjesh mësimore që mundësojnë gjithëpërfshirje, barazi dhe pjesmarrje aktive të nxënësve dhe kursantëve në seancat mësimore. – Përshtat qasjet mësimore në përputhje me veçoritë individuale të nxënësve dhe kursantëve.	– Të jetë korrekt/e – Të jetë bashkëpunues/e – Të jetë i/e kujdesshëm – Të jetë i/e përpiktë – Të komunikojë me etikë profesionale. – Të ketë paraqitje korrekte – Të jetë këmbëngulës – Të jetë i/e vendosur. – Të jetë i/e duruar. – Të jetë krijues. – Të jetë empatik/e.	– Të zbatojë planin e mësimdhënies së seancave mësimore, teorike dhe/ose praktike. – Të përmbushë objektivat mësimore dhe rezultatet e të nxënit për seancat mësimore. – Të përdatitë dhe përdorë llojshmëri materialesh mësimore didaktike mbështetëse. – Të përdorë llojshmëri teknologjish dhe mediesh didaktike moderne. – Të zbatojë llojshmëri qasjesh mësimore që mundësojnë aktivizimin, gjithëpërfshirjen dhe barazinë gjinore e sociale të nxënësve e kursantëve. – Të zbatojë llojshmëri qasjesh mësimore që mundësojnë mësimin e individualizuar të nxënësve dhe kursantëve.

	dhe gjithëpërfshirje të nxënësve dhe kursantëve në seancat mësimore. 7. Zbaton qasje mësimore që mundësojnë barazinë sociale dhe gjinore të nxënësve dhe kursantëve në seancat mësimore 8. Zbaton qasje mësimore që përshtaten me veçoritë individuale të nxënësve dhe kursantëve në seancat mësimore 9. Zbaton qasje mësimore që mundësojnë zhvillimin e kompetencave profesionale të nxënësve dhe kursantëve në seancat mësimore. 10. Zbaton qasje mësimore që mundësojnë zhvillimin e kompetencave kyçe dhe aftësive të "buta" të nxënësve dhe kursantëve në seancat mësimore 11. Zbaton qasje mësimore që mundësojnë të nxënit përtej prezencës fizike të nxënësve dhe kursantëve në seancat mësimore; 12. Zbaton qasje mësimore që mundësojnë bashkëpunimin dhe punën në grup të nxënësve dhe kursantëve në seancat mësimore. 13. Zbaton qasje mësimore që zhvillojnë qëndrimet dhe vlerat e nxënësve dhe kursantëve në seancat mësimore. 14. Zbaton qasje mësimore që motivojnë të nxënit e nxënësve dhe kursantëve në seancat	të nxënësve dhe kursantëve në seancat mësimore. • Veçoritë e qasjeve mësimore që mundësojnë zhvillimin e kompetencave profesionale të nxënësve dhe kursantëve. • Veçoritë e qasjeve mësimore që mundësojnë zhvillimin e kompetencave kyçe dhe aftësive të "buta" të nxënësve dhe kursantëve në seancat mësimore. • Veçoritë e qasjeve mësimore që mundësojnë të nxënit përtej prezencës fizike të nxënësve dhe kursantëve. • Veçoritë e qasjeve mësimore që mundësojnë bashkëpunimin dhe punën në grup të nxënësve dhe kursantëve. • Veçoritë e qasjeve mësimore që zhvillojnë qëndrimet dhe vlerat e nxënësve dhe kursantëve. • Veçoritë e qasjeve mësimore që motivojnë të nxënit e nxënësve dhe kursantëve. • Veçoritë e qasjeve mësimore që vendosin nxënësit dhe kursantët në qendër të procesit mësimor. • Veçoritë e parimetve diaktike në procesin mësimor. • Procedurat e realizimit të seancave mësimore teorike. • Procedurat e realizimit të seancave mësimore praktike. • Mjetet, platformat dhe nxitësat digjitale gjatë realizimit të seancave mësimore • Mënyrat e integrimit të teorisë me praktikën gjatë realizimit të	– Zbaton llojshmëri qasjesh mësimore që mundësojnë zhvillimin e kompetencave profesionale, aftësive "të buta" dhe kompetencave kyce të nxënësve dhe kursantëve. – Zbaton llojshmëri qasjesh mësimore që mundësojnë të nxënit përtej prezencës fizike të nxënësve dhe kursantëve në seancat mësimore. – Zbaton llojshmëri qasjesh mësimore që mundësojnë bashkëpunimin, punën në grup dhe motivimin e nxënësve dhe kursantëve në seancat mësimore. – Zbaton llojshmëri qasjesh mësimore që zhvillojnë qëndrimet dhe vlerat e nxënësve dhe kursantëve. – Zbaton llojshmëri qasjesh mësimore që i vendosin nxënësit dhe kursantët në qendër të procesit mësimor – Zbaton procedura të realizimit të seancave mësimore teorike dhe/ose praktike. – Përdor llojshmëri mjetesh, platformash dhe nxitësash digjitale për realizimin e seancave mësimore – Zbaton llojshmëri qasjesh mësimore që integrojnë teorinë me praktikën gjatë realizimit të seancave mësimore.		– Të zbatojë llojshmëri qasjesh mësimore që mundësojnë zhvillimin e kompetencave profesionale, aftësive "të buta" dhe kompetencave kyçe të nxënësve dhe kursantëve – Të zbatojë llojshmëri qasjesh mësimore që mundësojnë të nxënit përtej prezencës fizike të nxënësve dhe kursantëve. – Të zbatojë llojshmëri qasjesh mësimore që mundësojnë bashkëpunimin dhe punën në grup të nxënësve dhe kursantëve. – Të zbatojë llojshmëri qasjesh mësimore që motivojnë dhe zhvillojnë qëndrimet dhe vlerat e nxënësve dhe kursantëve. – Të zbatojë llojshmëri qasjesh mësimore që vendosin nxënësit dhe kursantët në qendër të procesit mësimor. – Të zbatojë parimet diaktike në realizimin e sprocesit mësimor. – Të zbatojë procedurat e realizimit efektiv të seancave mësimore teorike dhe praktike. – Të përdorë mjete, platforma dhe nxitësa digjitale gjatë realizimit të procesit mësimor. – Të menaxhojë kohën si dhe problemet e konfliktet që mund të krijohen gjatë realizimit të seancave mësimore. – Të zbatojë llojshmëri qasjesh mësimore që integrojë teorinë me praktikën gjatë procesit mësimor.

	mësimore. 15. Vendos nxënësit dhe kursantët në qendër të procesit mësimor 16. Zbaton parimet diaktike në realizimin e seancave mësimore 17. Zbaton procedurat e realizimit efektiv të seancave mësimore teorike. 18. Zbaton procedurat e realizimit efektiv të seancave mësimore praktike. 19. Përdor mjete, platforma dhe nxitësa digjitale gjatë realizimit të seancave mësimore 20. Menaxhon problemet dhe konfliktet e mundëshme që krijohen gjatë realizimit të seancave mësimore. 21. Menaxhon me efektivitet kohën dhe ritmin e realizimit të seancave mësimore. 22. Integron teorinë me praktikën gjatë realizimit të seancave mësimore	seancave mësimore			
4.Vlerësimi i arritjeve të nxënësve/ kursantëve të AFP-së	1. Planifikon procesin e vlerësimit të nxënësve kursantëve në ofruesit e AFP dhe në biznese. 2. Zbaton kërkesat ligjore, rregullatore dhe institucionale gjatë procesit të vlerësimit të nxënësve dhe kursantëve. 3. Zbaton parimet e vlerësimit të nxënësve dhe kursantëve. 4. Vlerëson nxënësit dhe kursantët me metoda dhe instrumente vlerësimi të	• Kuptimi, parimet dhe llojet e vlerësimit të nxënësve dhe kursantëve në AFP. • Kuadri ligjor, rregullator dhe institucional ku bazohet vlerësimi i nxënësve dhe kursantëve në AFP. • Parimet, metodat dhe instrumentet e vlerësimit. • Vleftshmëria, besueshmëria, transparenca dhe objektiviteti, si tipare të një vlerësimi të	– Planifikon procesin e vlerësimit të nxënësve kursantëve në ofruesit e AFP dhe në biznese. – Zbaton kërkesat ligjore, rregullatore dhe institucionale gjatë procesit të vlerësimit të nxënësve dhe kursantëve. – Zbaton parimet e vlerësimit të nxënësve dhe kursantëve. – Përdor metoda dhe instrumente vlerësimi të	– Të jetë korrekt/e – Të jetë bashkëpunues/e – Të jetë i/e kujdesshëm – Të jetë i/e përpiktë – Të komunikojë me etikë profesionale. – Të ketë paraqitje korrekte – Të jetë këmbëngulës – Të jetë i/e vendosur.	– Të planifikojë procesin e vlerësimit të nxënësve kursantëve në ofruesit e AFP dhe në biznese. – Të zbatojë kërkesat ligjore, rregullatore dhe institucionale për procesin e vlerësimit të nxënësve dhe kursantëve. – Të përshkruajë parimet e vlerësimit të nxënësve dhe kursantëve. – Të përgatitë instrumente vlerësimi të vlefshme, të besueshme dhe objektive. – Të përgatitë dhe përdorë lloje të

	vlefshme, të besueshme dhe objektive. 5. Përgatit dhe përdor instrumente vlerësimi (të printuara dhe digjitale) specifike për vlerësimin e njohurive të nxënësve dhe kursantëve. **6.** Përgatit dhe përdor instrumente vlerësimi (të printuara dhe digjitale) specifike për vlerësimin e shprehive praktike të nxënësve dhe kursantëve. 7. Përgatit dhe përdor instrumente vlerësimi (të printuara dhe digjitale) specifike për vlerësimin e dhe qëndrimeve dhe vlerave të nxënësve dhe kursantëve. 8. Garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, të nxënësve dhe kursantëve. 9. Realizon vlerësimin e njohurive të nxënësve dhe kursantëve. 10. Realizon vlerësimin e shprehive praktike të nxënësve dhe kursantëve. 11. Udhëzon nxënësit për provimet përfundimtare 12. Realizon vlerësimin e qëndrimeve dhe vlerave të nxënësve dhe kursantëve. 13. Jep fidbek konstruktiv dhe në kohë reale të vlerësimit të nxënësve dhe kursantëve 14. Analizon dhe interpreton të dhënat e vlerësimit të nxënësve dhe kursantëve 15. Plotëson dokumentacionin për	mirë. • Llojet dhe veçoritë e instrumenteve të vlerësimit (të printuara dhe digjitale) të njohurive të nxënësve dhe kursantëve. • Llojet dhe veçoritë e instrumenteve të vlerësimit (të printuara dhe digjitale) të shprehive praktike të nxënësve dhe kursantëve. • Llojet dhe veçoritë e instrumenteve të vlerësimit (të printuara dhe digjitale) të qëndrimeve dhe vlerave të nxënësve dhe kursantëve. • Struktura dhe veçoritë e testeve për njohuritë teorike të nxënësve dhe kursantëve. • Struktura dhe veçoritë e listave të kontrollit për vlerësimin e shprehive praktike të nxënësve dhe kursantëve. • Kërkesat dhe rregullat për provimet përfundimtare • Rëndësia e dhënies së fidbekut konstruktiv dhe në kohë reale të vlerësimit të nxënësve dhe kursantëve • Rëndësia e interpretimit të të dhënave të vlerësimit të nxënësve dhe kursantëve	vlefshme, të besueshme dhe objektive, për vlerësimin e nxënësve dhe kursantëve. – Përgatit dhe përdor llojshmëri instrumentesh vlerësimi (të printuara dhe digjitale) të njohurive të nxënësve dhe kursantëve. – Përgatit dhe përdor llojshmëri instrumentesh vlerësimi (të printuara dhe digjitale) të shprehive praktike të nxënësve dhe kursantëve. – Përgatit dhe përdor llojshmëri instrumentesh vlerësimi (të printuara dhe digjitale) të qëndrimeve dhe vlerave të nxënësve dhe kursantëve. – Kryen vlerësime të njohurive, shprehive praktike, qëndrimeve dhe vlerave të nxënësve dhe kursantëve – Udhëzon nxënësit për provimet përfundimtare – Jep fidbek konstruktiv dhe në kohë reale për vlerësimin e nxënësve dhe kursantëve – Kryen analizën dhe interpretimin e të dhënave të vlerësimit të nxënësve dhe kursantëve	– Të jetë i/e duruar. – Të jetë krijues. – Të jetë empatik/e.	ndryshme të instrumenteve të vlerësimit (të printuara dhe digjitale) të njohurive të nxënësve dhe kursantëve. – Të përgatitë dhe përdorë lloje të ndryshme të instrumenteve të vlerësimit (të printuara dhe digjitale) të shprehive praktike të nxënësve dhe kursantëve. – Të përgatitë dhe përdorë lloje të ndryshme të instrumenteve të vlerësimit (të printuara dhe digjitale) të qëndrimeve dhe vlerave të nxënësve dhe kursantëve. – Përshkruan karakteristikat e vlerësimit të drejtë dhe transparent të nxënësve dhe kursantëve. – Të kryejë vlerësimin e njohurive, shkathtësive praktike dhe vlerave e qëndrimeve të nxënësve dhe kursantëve. • Kërkesat dhe rregullat për provimet përfundimtare – Të jape fidbek konstruktiv dhe në kohë reale të vlerësimit të nxënësve dhe kursantëve – Të interpretojë të dhënat e vlerësimit të nxënësve dhe kursantëve

	vlerësimin dhe provimet				
5. Zhvillimi i aftësive "të buta" të nxënësve dhe kursantëve.	1. Integron veprimtari mësimore që zhvillojnë komunikimin me etikë profesionale të nxënësve dhe kursantëve. 2. Integron veprimtari mësimore që zhvillojnë aftësitë për punë në grup dhe bashkëpunim të nxënësve dhe kursantëve. 3. Integron veprimtari mësimore që zhvillojnë të menduarit kritik dhe krijues të nxënësve e kursantëve 4. Integron veprimtari mësimore që zhvillojnë aftësitë planifikuese, organizuese dhe drejtuese të nxënësve dhe kursantëve. 5. Integron veprimtari mësimore që zhvillojnë fleksibilitetin dhe përshtatshmërinë e nxënësve dhe kursantëve. 6. Integron veprimtari mësimore që zhvillojnë humanizmin dhe tolerancën e nxënësve dhe kursantëve 7. Integron veprimtari mësimore që zhvillojnë aftësitë sipërmarrëse të nxënësve dhe kursantëve. 8. Integron veprimtari mësimore që zhvillojnë aftësitë për negociim dhe zgjidhje problemesh e konfliktesh, të nxënësve dhe kursantëve 9. Integron veprimtari mësimore që zhvillojnë aftësitë analizuese dhe sintetizuese të nxënësve dhe kursantëve. 10. Integron veprimtari mësimore që zhvillojnë disiplinën dhe	• Klasifikimi, veçoritë dhe rëndësia e aftësive "të buta" për formimin profesional të nxënësve dhe kursantëve. • Veçoritë e veprimtarive mësimore që zhvillojnë komunikimin me etikë profesionale të nxënësve dhe kursantëve. • Veçoritë e veprimtarive mësimore që zhvillojnë aftësitë për punë në grup e bashkëpunim të nxënësve dhe kursantëve. • Veçoritë e veprimtarive mësimore që zhvillojnë të menduarit kritik dhe krijues të nxënësve e kursantëve • Veçoritë e veprimtarive mësimore që zhvillojnë aftësitë planifikuese, organizuese dhe drejtuese të nxënësve dhe kursantëve. • Veçoritë e veprimtarive mësimore që zhvillojnë fleksibilitetin e përshtatshmërinë e nxënësve dhe kursantëve. • Veçoritë e veprimtarive mësimore që zhvillojnë humanizmin dhe tolerancën e nxënësve dhe kursantëve • Veçoritë e veprimtarive mësimore që zhvillojnë aftësitë sipërmarrëse të nxënësve dhe kursantëve. • Veçoritë e veprimtarive mësimore që zhvillojnë aftësitë e nxënësve dhe kursantëve për negociim dhe zgjidhje problemesh e konfliktesh. • Veçoritë e veprimtarive	– Moderon veprimtari që zhvillojnë komunikimin me etikë profesionale të nxënësve dhe kursantëve. – Moderon veprimtari që zhvillojnë aftësitë për punë në grup dhe bashkëpunim të nxënësve dhe kursantëve. – Moderon veprimtari që zhvillojnë të menduarit kritik dhe krijues të nxënësve e kursantëve – Moderon veprimtari që zhvillojnë aftësitë planifikuese, organizuese dhe drejtuese të nxënësve dhe kursantëve. – Moderon veprimtari që zhvillojnë fleksibilitetin dhe përshtatshmërinë e nxënësve dhe kursantëve. – Moderon veprimtari që zhvillojnë humanizmin dhe tolerancën e nxënësve dhe kursantëve – Moderon veprimtari që zhvillojnë aftësitë sipërmarrëse të nxënësve dhe kursantëve. – Moderon veprimtari që zhvillojnë aftësitë për negociim dhe zgjidhje problemesh e konfliktesh, të nxënësve dhe kursantëve – Moderon veprimtari që zhvillojnë aftësitë analizuese dhe sintetizuese të nxënësve dhe kursantëve – Moderon veprimtari që	– Të jetë korrekt/e – Të jetë bashkëpunues/e – Të jetë i/e kujdesshëm – Të jetë i/e përpiktë – Të komunikojë me etikë profesionale. – Të ketë paraqitje korrekte – Të jetë këmbëngulës – Të jetë i/e vendosur. – Të jetë i/e duruar. – Të jetë krijues. – Të jetë empatik/e.	– Të klasifikojë aftësitë "e buta". – Të përshkruajë veçoritë dhe argumentojë rëndësinë e aftësive "të buta" për formimin profesional të nxënësve dhe kursantëve. – Të planifikojë dhe moderojë veprimtari që zhvillojnë komunikimin me etikë profesionale të nxënësve dhe kursantëve. – Të planifikojë dhe moderojë veprimtari që zhvillojnë aftësitë për punë në grup dhe bashkëpunim të nxënësve dhe kursantëve. – Të planifikojë dhe moderojë veprimtari që zhvillojnë të menduarit kritik dhe krijues të nxënësve e kursantëve – Të planifikojë dhe moderojë veprimtari që zhvillojnë aftësitë planifikuese, organizuese dhe drejtuese të nxënësve e kursantëve. – Të planifikojë dhe moderojë veprimtari që zhvillojnë fleksibilitetin dhe përshtatshmërinë e nxënësve dhe kursantëve. – Të planifikojë dhe moderojë veprimtari që zhvillojnë humanizmin dhe tolerancën e nxënësve dhe kursantëve – Të planifikojë dhe moderojë veprimtari që zhvillojnë aftësitë sipërmarrëse të nxënësve dhe kursantëve. – Të planifikojë dhe moderojë veprimtari që zhvillojnë aftësitë për negociim dhe zgjidhje problemesh e konfliktesh, të nxënësve dhe kursantëve – Të planifikojë dhe moderojë veprimtari që zhvillojnë aftësitë

	korrektësinë e nxënësve dhe kursantëve. 11. Integron veprimtari mësimore që zhvillojnë aftësitë digjitale të nxënësve e kursantëve 12. Integron veprimtari mësimore që zhvillojnë aftësitë "e gjelbra" të nxënësve dhe kursantëve 13. Integron veprimtari mësimore që zhvillojnë aftësitë e nxënësve dhe kursantëve për të garantuar sigurinë dhe mirëqenien e tyre. 14. Integron veprimtari mësimore që zhvillojnë aftësitë e nxënësve dhe kursantëve për të bërë zgjedhje në karrierë. 15. Mbështet zhvillimin e aftësive të nxënësve dhe kursantëve për të nxënit gjatë gjithë jetës. 16. Integron veprimtari mësimore që zhvillojnë kreativitetin dhe nismat për risi të nxënësve dhe kursantëve 17. Integron veprimtari mësimore që zhvillojnë aftësitë drejtuese dhe udhëheqëse të nxënësve dhe kursantëve.	mësimore që zhvillojnë aftësitë analizuese dhe sintetizuese të nxënësve dhe kursantëve. • Veçoritë e veprimtarive mësimore që zhvillojnë disiplinën dhe korrektësinë e nxënësve dhe kursantëve. • Veçoritë e veprimtarive mësimore që zhvillojnë aftësitë digjitale të nxënësve dhe kursantëve. • Veçoritë e veprimtarive mësimore që zhvillojnë aftësitë "e gjelbra" të nxënësve dhe kursantëve. • Veçoritë e veprimtarive mësimore që zhvillojnë aftësitë e nxënësve dhe kursantëve për të garantuar sigurinë dhe mirëqenien e tyre. • Veçoritë e veprimtarive mësimore që zhvillojnë aftësitë e nxënësve dhe kursantëve për të bërë zgjedhje në karrierë. • Kuptimi, veçoritë dhe rëndësia e të nxënit gjatë gjithë jetës. • Veçoritë e veprimtarive mësimore që zhvillojnë kreativitetin dhe nismat për risi të nxënësve dhe kursantëve • Veçoritë e veprimtarive mësimore që zhvillojnë aftësitë drejtuese dhe udhëheqëse të nxënësve dhe kursantëve.	zhvillojnë disiplinën dhe korrektësinë e nxënësve dhe kursantëve. – Moderon veprimtari që zhvillojnë aftësitë digjitale të nxënësve e kursantëve – Moderon veprimtari që zhvillojnë aftësitë "e gjelbra" të nxënësve dhe kursantëve – Moderon veprimtari që zhvillojnë aftësitë e nxënësve dhe kursantëve për të garantuar sigurinë dhe mirëqenien e tyre. – Moderon veprimtari që zhvillojnë aftësitë e nxënësve dhe kursantëve për të bërë zgjedhjet e duhura në karrierë. – Moderon veprimtari që zhvillojnë aftësitë e nxënësve dhe kursantëve për të nxënit gjatë gjithë jetës. – Moderon veprimtari që zhvillojnë kreativitetin dhe nismat për risi të nxënësve dhe kursantëve – Moderon veprimtari që zhvillojnë aftësitë drejtuese dhe udhëheqëse të nxënësve dhe kursantëve.		analizuese dhe sintetizuese të nxënësve dhe kursantëve. – Të planifikojë dhe moderojë veprimtari që zhvillojnë disiplinën dhe korrektësinë e nxënësve dhe kursantëve. – Të planifikojë dhe moderojë veprimtari që zhvillojnë aftësitë digjitale të nxënësve dhe kursantëve – Të planifikojë dhe moderojë veprimtari që zhvillojnë aftësitë "e gjelbra" të nxënësve dhe kursantëve – Të planifikojë dhe moderojë veprimtari që zhvillojnë aftësitë e nxënësve dhe kursantëve për të garantuar sigurinë dhe mirëqenien e tyre. – Të planifikojë dhe moderojë veprimtari që zhvillojnë aftësitë e nxënësve dhe kursantëve për të bërë zgjedhjet e duhura në karrierë. – Të mbështetë zhvillimin e aftësive të nxënësve dhe kursantëve për të nxënit gjatë gjithë jetës. – Të planifikojë dhe moderojë veprimtari që zhvillojnë kreativitetin dhe nismat për risi të nxënësve dhe kursantëve – Të planifikojë dhe moderojë veprimtari që zhvillojnë aftësitë drejtuese dhe udhëheqëse të nxënësve dhe kursantëve.
6. Krijimi i marrëdhënieve profesionale në punë	1. Mban marrëdhënie bashkëpunuese, etike dhe efektive me eprorët, kolegët dhe aktorët e tjerë të AFP-së. 2. Krijon marrëdhënie etike dhe empatie me nxënësit	• Tiparet e një mësimdhënësi të mirë në sektorin e AFP-së • Veçoritë e marrëdhënieve bashkëpunuese, etike dhe efektive të mësimdhënësit të AFP-së. • Veçoritë e marrëdhënieve etike	– Bashkëpunon dhe komunikon me etikë me eprorët, kolegët dhe aktorët e tjerë të AFP-së. – Komunikon me etikë me nxënësit dhe kursantët. – Vepron në përputhje me	– Të jetë korrekt/e – Të jetë bashkëpunues/e – Të jetë i/e kujdesshëm – Të jetë i/e përpiktë	– Të krijojë marrëdhënie bashkëpunuese, etike dhe efektive me eprorët, kolegët dhe aktorët e tjerë të AFP-së. – Të krijojë marrëdhënie respekti, etike dhe empatie me nxënësit dhe kursantët

	dhe kursantët. 3. Komunikon me etikë dhe me qartësi me nxënësit dhe kursantët. 4. Respekton normat morale dhe profesionale 5. Trajton me dinjitet dhe drejtësi nxënësit dhe kursantët. 6. Respekton individualitetin e nxënësve dhe kursantëve. 7. Respekton diversitetin gjinor, rracor, fetar, etnik dhe social të nxënësve dhe kursantëve. 8. Gjykon dhe vlerëson me drejtësi, objektivitet dhe transparencë. 9. Shmang mbivlerësimin ose nënvlerësimin e nxënësve dhe kursantëve. 10. Krijon marrëdhënie të respektit të ndërsjellë me nxënësit dhe kursantët. 11. Motivon dhe mbështet nxënësit dhe kursantët. 12. Garanton siguri fizike dhe psikologjike, pa frikë, dhunë, tallje apo presion për nxënësit dhe kursantët. 13. Garanton privatësinë dhe konfidencialitetin e nxënësve dhe kursantëve. 14. Zgjidh me tolerancë problemet dhe konfliktet në kontekstin profesional. 15. Refuzon favorizimet në kontekstin profesional. 16. Respekton rolet dhe përgjegjësitë profesionale të kolegëve.	dhe empatike të mësimdhënësit, me nxënësit dhe kursantët. • Veçoritë e komunikimit me etikë dhe me qartësi të mësimdhënësit, me nxënësit dhe kursantët. • Normat morale e profesionale në fushën e mësimdhënies. • Veçoritë e trajtimit me dinjitet dhe drejtësi të nxënësve dhe kursantëve. • Veçoritë e respektimit të individualitetit të nxënësve dhe kursantëve. • Parimet e respektimit të diversitetit gjinor, rracor, fetar, etnik dhe social të nxënësve dhe kursantëve. • Drejtësia, objektiviteti dhe transparenca në vlerësimin e nxënësve dhe kursantëve. • Veçoritë e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë të mësimdhënësit me nxënësit dhe kursantët. • Rëndësia e motivimit dhe e mbështetjes së nxënësve dhe kursantëve. • Veçoritë e sigurisë fizike dhe psikologjike për nxënësit dhe kursantët. • Rëndësia e garantimit të privatësinë dhe konfidencialitetit të nxënësve dhe kursantëve. • Roli i tolerancës për zgjidhjen e problemeve dhe konflikteve në kontekstin profesional. • Rëndësia e respektimit të roleve dhe përgjegjësive profesionale	normat morale dhe profesionale. - Respekton dinjitetin, diversitetin dhe veçoritë individuale të nxënësve dhe kursantëve. - Shfaq drejtësi, objektivitet dhe transparencë me nxënësit dhe kursantët. - Tregon respekt për nxënësit dhe kursantët. - Motivon dhe mbështet nxënësit dhe kursantët. - Krijon siguri fizike dhe psikologjike për nxënësit dhe kursantët. - Ruan privatësinë dhe konfidencialitetin e nxënësve dhe kursantëve. - Tregon tolerancë në zgjidhjen e problemeve dhe konflikteve në kontekstin profesional. - Bashkëpunon në përputhje me rolet dhe përgjegjësitë profesionale të kolegëve.	- Të komunikojë me etikë profesionale. - Të ketë paraqitje korrekte - Të jetë këmbëngulës - Të jetë i/e vendosur - Të jetë i/e duruar. - Të jetë krijues. - Të jetë empatik/e.	- Të komunikojë me etikë dhe me qartësi me nxënësit dhe kursantët - Të zbatojë normat morale dhe profesionale gjatë veprimtarisë profesionale - Të trajtojë me dinjitet dhe drejtësi nxënësit dhe kursantët. - Të respektojë individualitetin dhe diversitetin gjinor, rracor, fetar, etnik dhe social të nxënësve dhe kursantëve. - Të bëjë gjykime dhe vlerësime me drejtësi, objektivitet e transparencë - Të motivojë dhe të mbështetë nxënësit dhe kursantët. - Të garantojë sigurinë fizike dhe të shmangë frikën, dhunën, tallje apo presionin për nxënësit e kursantët. - Të garantojë privatësinë dhe konfidencialitetin e nxënësve dhe kursantëve. - Të zgjidhë me tolerancë problemet dhe konfliktet e mundëshme në kontekstin profesional. - Të refuzojë favorizimet e mundëshme në kontekstin profesional. - Të respektojë rolet e përgjegjësitë profesionale të kolegëve.

		të kolegëve.			
